



Nr. Prot. **341**

Tiranë, më **20/10/2025**

Kriteret dhe procedurat e pranimit

**PROGRAM I STUDIMIT MASTER UNIVERSITAR I NIVELIT TË PARË /
MASTER PROFESIONAL NË "INFIRMIERISTIKË NË KUJDESHIN
PARËSOR: KOMPETENCA DIGITALE, MENAXHERIALE DHE KLINIKE
PËR INFIRMIERIN E FAMILJES DHE TË KOMUNITETIT"**

Viti akademik 2025 -2026

UDHËZIME ME KARAKTER TË PËRGJITHSHËM

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Universiteti i Romës "Tor Vergata" në përputhje me legjislacionin Universitar Shqiptar dhe Italian në fuqi në shtetet përkatëse, çelin për vitin akademik 2025-2026, *Master Universitar i Nivelit të Parë / Master Profesional në "Infermieristikë në Kujdesin Parësor: Kompetenca Digitale, Menaxheriale dhe Klinike për Infermierin e Familjes dhe të Komunitetit"*.

KUOTA NË DISPOZICION DHE KRITERET E PRANIMIT

Për vitin akademik 2025 -2026, në programin e studimit *Master Universitar i Nivelit të Parë / Master Profesional në "Infermieristikë në Kujdesin Parësor: Kompetenca Digitale, Menaxheriale dhe Klinike për Infermierin e Familjes dhe të Komunitetit"* janë të rezervuara **32 kuota** për kandidatët shqiptarë; **20 kuota** për kandidatët nga vendet e BE-së dhe nga vendet e tjera jo anëtare të BE-së dhe **2 kuota** për shtetasit e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë në *Master Universitar i Nivelit të Parë / Master Profesional në "Infermieristikë në Kujdesin Parësor: Kompetenca Digitale, Menaxheriale dhe Klinike për Infermierin e Familjes dhe të Komunitetit"* kandidatët duhet të jenë të pajisur me një diplomë 3-vjeçare në Infermieri të lëshuar nga një Universitet i akredituar.

MËNYRA E APLIKIMIT PËR KONKURSIN E PRANIMIT

Për të aplikuar, kandidatët duhet të kryejnë procedurën e regjistrimit online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës **23 nëntor 2025, ora 23:59**, duke bashkëngjitur një kopje elektronike në formatin PDF të dokumentacionit vijues:

- 1- Diploma universitare.
- 2- Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara gjatë studimeve universitare të kryera më parë.
- 3- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti).



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Pas ngarkimit të gjithë dokumentacionit të mësipërm, kandidatët e huaj duhet të paguajnë **brenda datës 23 nëntor 2025** tarifën për aplikimin¹ prej 50 Euro si vijon:

- Me transfertë bankare në llogarinë² me këto të dhëna:
Përfituesi: Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
Banka: Intesa San Paolo Bank
BIC/Swift: USALALTR
IBAN: AL60208112040000030694935302
- me kartë krediti online në portalin e Universitetit : <https://admissions.unizkm.al/>;
- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Më pas do të kryhet kontrolli i dokumentave për secilin kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin e Universitetit.

Kandidatët që konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit, duhet të paguajnë edhe tarifën e pjesëmarrjes në intervistën **brenda datës 26 nëntor 2025, ora 16:30**:

- 2,000 lekë për shtetasit shqiptarë dhe shtetasit e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi;
- 100 euro për kandidatët e tjerë të huaj.

Pagesa do të kryhet me të njëjtat mënyra të përdorura për të paguar tarifën e aplikimit prej 50 Euro.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit të ciklit të dytë *Master Profesional në "Infermieristikë në Kujdesin Parësor: Kompetenca Digitale, Menaxheriale dhe Klinike për Infermierin e Familjes dhe të Komunitetit"* do të zhvillohet përmes një testimi me shkrim në gjuhën italiane, në formën e një testi shkencor për lëndet profesionale e cila do të zhvillohet në datën **2 dhjetor 2025, ora 11:00** në selinë e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Rruga "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri. Testimi përmban 80 pikë.

Në rast se numri i kandidatëve do të jetë më i ulët se kuotat e parashikuara, do të zhvillohet një intervistë motivuese.

Rezultatet e testimit do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/> **brenda datës 3 dhjetor 2025.**

¹ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

² Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e intervistës duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



REGJISTRIMI

Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me prokurë noteriale, deri **në datën 9 dhjetor 2025** dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Mandatin e kryerjes së pagesës së tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri "Tariffe");
2. Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
3. Kopjen e dokumentit të identifikimit;
4. Certifikata Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në zbatim të dekreteve në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin për ta dorëzuar)
5. Dy fotografi personale;

Ne rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj, dokumentacioni duhet të jete i pajisur me vulen apostille te vendit te orgjines.

Në rastet kur dokumentacioni i parashikuar vjen nga një Universitet i huaj dhe nuk është në gjuhën shqipe apo italiane, ai duhet përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e parë e hyrjes në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo tëpasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor duhet të aplikojnë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Kandidatët të cilët nuk janë në përputhje me dorëzimin e dokumenteve të lartpërmendura do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të mund t'i nënshtrohen provimeve derisa të disponohet dokumentacioni i kërkuar. Regjistrimi me rezervë do të thotë se mospërmbushja e kërkesave brenda afateve të përcaktuara me dekretet ministrore mund të rezultojë në mosmarrjen e statusit të studentit dhe për rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. **Kandidatët e suksesshëm do të regjistrohen në vitin e parë të kursit me rezerva derisa të marrin numrin matrikullimit nga QSHA.**

Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një universitet i huaj, ai duhet të dorëzohet në:

- Sekretarinë Mësimore në kopje të noterizuar.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- QSHA për ekuivalentimin në kopje të noterizuar, apostilluar dhe përkthyer në shqip.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.
- Deklaratat sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr. 2 të Udhëzimit nr.12 të datës 30/06/2023.

Nëse një kandidat i shpallur fitues, nuk kryen regjistrimin brenda afateve të caktuara, e humbet automatikisht të drejtën e regjistrimit. Numri minimal i studentëve të regjistruar, i domosdoshëm për nisjen e programit të studimit, është 21 studentë.

Rectori



Prof. Leonardo Palombi